

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 nëntor 2014**, mori këtë:

V E N D I M PËR KONFIRMIMIN E GATISHMËRISË PËR BASHKËFINANCIM

Neni 1

1. Me këtë Vendim konfirmohet gatishmëria e Komunës së Vushtrrisë për bashkëfinancim të projektit KSV/018 në vlerë prej shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë euro (760.000 €) për ndërtim të rrjetit të ujësjellësit si në vijim:

- 1.1. ndërrimi i gypave të ujësjellësit në rr. “Bedri Pejani, Vesli Klark, Mehmet Konjuhi, Lidhja e Lezhës, Zahir Pajaziti, Nexhip Dragaj dhe Shemsi Istrefi”;
- 1.2. montimi i treqind (300) ujëmatësve në ekonomitë familjare;
- 1.3. instalimi i gypit të ri Smrekonicë – Vushtrri;
- 1.4. ndërrimi i gypit në hyrje të qytetit;
- 1.5. instalimi i ujëmatësit në hyrje të rezervuarit në Vushtrri;
- 1.6. instalimi i ujëmatësve në disa zona të qytetit;
- 1.7. riparimi i pajisjeve elektrike në rezervuarin e ujit në Vushtrri.

2. Projekti në fjalë duhet të realizohet në dy faza: në fazën e parë (viti 2015) LUX DEVOLOPMNET do të investojë në vlerën prej treqind e pesë mijë euro (305.000 €), ndërsa në fazën e dytë (vitet 2015-2016) do të shfrytëzohen mjetet tjera në shumën prej njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë euro (155.000 €) të LUX DEVOLOPMNET, si dhe mjetet e komunës në vlerë prej treqind mijë euro (300.000 €), të cilat duhet të sigurohen si vijon:

- 2.1. shuma prej tridhjetë mijë euro (30.000 € - nga fondi për bashkëfinancim) deri në muajin prill 2015;
- 2.2. shuma prej dyqind e shtatëdhjetë mijë euro (270.000 €) duhet të sigurohet me buxhetin e vitit 2016, deri në muajin prill 2016.

3. Autorizohet Kryetari i Komunës që të nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit me LUX DEVELOPMENT për realizimin e projektit në fjalë.


Neni 2

Obligohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa që mjetet financiare në shumën prej dyqind e shtatëdhjetë mijë euro (270.000 €) të përfshihen (planifikohen) me buxhetin e vitit 2016.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

 Shpëtim Zhegrova
Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 44.1 të Ligjit Nr.02/L-26 mbi tokën bujqësore, nenin 6.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 nëntor 2014**, mori këtë:

V E N D I M
MBI LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË
TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Me këtë Vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, e cila është e evidentuar në Certifikatën parcela kadastrale P-70202022-00622-3 me kulturë “arë” e klasës së pestë (5-të) në sipërfaqe prej 2979 m² Zona Kadastrale Gracë, pronë e Burim (Azem) Selmani me vendbanim në Mitrovicë.

Neni 2

Në parcelën kadastrale të cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi lejohet ndërtimi i objektit (depo frigorifer), i cili do të shërben për ushtrimin e veprimtarisë për grumbullimin e pemëve dhe perimeve.

Neni 3

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore do ta lëshojë lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga neni 2 i këtij vendimi dhe të duke vepruar konform dispozitave ligjore.

Neni 4

Obligohet pronari i parcelës nga neni 1 i këtij Vendimi që përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 “b” të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 6


Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, nenin 13 të Rregullores 01Nr.74/14, dt.27.03.2014 për përcaktimin e kriterëve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale, Kuvendi i Komunës së Vushtrrië në mbledhjen e mbajtur më **27 nëntor 2014**, mori këtë:

V E N D I M **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE BANESORE**

Neni 1

1. Me këtë Vendim formohet komisioni për çështje banesore për banesat në pronësi të komunës sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, në këtë përbërje:

- 1.1. Safet Osmani, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2. Fatime Haziri, anëtare e kuvendit (LDK);
- 1.3. Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit (LVV);
- 1.4. Ermal Lahu, anëtar i kuvendit (PD);
- 1.5. Naim Ferizi, zyrtar i komunës;
- 1.6. Behram Rrahmani, zyrtar i komunës;
- 1.7. Ramiz Bunjaku, zyrtar i QPS-së.

Neni 2

Zgjedhja e kryetarit të komisionit, mandati dhe kompetencat e komisionit janë të rregulluara me dispozitat e nenit 13, 14 dhe 15 të Rregullores 01Nr.74/14 dt. 27.03.2014 për përcaktimin e kriterëve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Komisioni në fjalë.



Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, nenin 8, paragrafi 2 të Rregullores 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011 për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 nëntor 2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJE TË MJETEVE FINANCIARE NGA FONDI PËR TRANSFERE
DHE SUBVENCIONE

Neni 1

Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në shumën prej një mijë euro (1000 €) nga buxheti i komunës (subvencione dhe transfere – Fondi për Emergjencë i Zyrës së Kryetarit të Komunës) për mbulim të shpenzimeve për material ndërtimor për ndërtimin e kulmit të shtëpisë për familjen e znj. Fatbardha Shabani nga fshati Pantinë.

Neni 2

Për zbatimin obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.


Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 nëntor 2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

Neni 1

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01Nr.330/12, dt.27.12.2012 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale në këtë përbërje:

- 1.1. Xhevahire Selmani, anëtare e kuvendit (PDK);
- 1.2. Agron Perquku, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.3. Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit (LVV);
- 1.4. Iliriana Nura, zyrtare e komunës;
- 1.5. Bajram Beqiri, zyrtar i komunës.

Neni 2

Mandati i këtij komisioni përfundon me rastin e dorëzimit për shqyrtim dhe aprovim në kuvendin e komunës të propozimeve për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni në fjalë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit

